



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

**ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE**

Nr. i Dokumentit: 24.15.1-2017-08

RAPORTI I AUDITIMIT

**PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË AGJENCISË
SHTETËRORE PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2017**

Prishtinë, prill 2018

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm, Valbon Bytyqi, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nga Udhëheqësja e ekipit, Selvete Foniqi dhe anëtarët Shefkije Beka dhe Adelina Selmani, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Faruk Rrahmani.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	10
4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	15
5 Qeverisja e mirë.....	16
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	18
Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake.....	21
Shtojca III: Letërkonfirmimi	25

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2017, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 13/02/2018.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2017 është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Zyra Kombëtare e Auditimit e vlerëson bashkëpunimin e treguar nga menaxhmenti i lartë dhe stafi i Agjencisë gjatë procesit të auditimit.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm


Opinion i pamodifikuar

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2017 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.*

Më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore



Përgjigja e Drejtorit të Përgjithshëm

Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë rekomandimet e dhëna.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut për auditimin e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (tash e tutje Agjencia). Ne kemi analizuar veprimtarinë e Agjencisë se deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e Auditorit të Përgjithshëm.

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Gjithashtu merret parasysh edhe deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave (MF).

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar

Ne kemi audituar PFV-të e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa "Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare". Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje për PFV

Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Drejtori i Përgjithshëm në mungesë të Kryesuesit të Këshillit të Agjencisë është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Agjencisë.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV-të në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbuloj çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Agjencia kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 01/2013 dhe 02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK);
- Kërkesat tjera për raportime buxhetore, siç janë raportet tremujore duke përfshirë edhe pasqyrat nëntëmujore me kohë; dhe
- Raportet për obligimet e papaguara.

Kërkesat për raportim në kontekst të PFV-ve dhe raportimit të jashtëm ishin përmbushur dhe nuk kemi çështje për të ngritur.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime lidhur me PFV-të.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë lidhur me MFK-në, pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit ishte menaxhimi i buxhetit, shpenzimet, burimet njerëzore, pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Në vitin 2017, Agjencia ka shpenzuar 75% të buxhetit final, me një shpenzim më të ulët për 16% krahasuar me vitin paraprak. Performanca e ulët buxhetore ishte e ndikuar kryesisht nga kategoria e pagave dhe mëditjeve, për faktin se buxheti i pagave të anëtarëve të Këshillit kishte mbetur i pashpenzuar si rezultat i përfundimit të mandati të Këshillit në korrik 2016, dhe mos emërimit të përbërjes së re nga Kuvendi i Kosovës.

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh kyçe nëpër sistemet financiare, por që përmirësime të mëtejshme janë të nevojshme në disa fusha për të siguruar një menaxhim efektiv. Fushat kryesore ku nevojiten përmirësime të mëtejme janë: që pozitat kyçe të jenë të aprovuara me buxhet, respektimi i plotë i rregullave financiare në procesimin e pagesave, respektim i rregulloreve në dhënien e pushimeve pa pagesë, dhe funksionalizimi i sistemit e-Pasuria.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Burimet e Fondeve:	353,242	284,794	212,288	268,062	348,713
Granti i Qeverisë -Buxheti	353,242	284,794	212,288	268,062	337,167
Donacionet e jashtme	-	-	-	-	11,546

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte reduktuar për 68,448€. Me rishikim të buxhetit kategoria e pagave dhe mëditjeve ishte zvogëluar për 50,000€, kurse me vendim të Qeverisë² si rezultat i kursimeve buxhetore i janë marrë Agjencisë fondet prej 18,488€ (13,488€ në kategorinë mallra shërbime, dhe 5,000€ në shërbime komunale).

¹ Buxheti final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga MF.

² Vendimi 10/19 i datës 15.12.2017.

Në vitin 2017, Agjencia ka shpenzuar 75% të buxhetit final ose 212,288€, që paraqet një shpenzim më të ulët për 16% krahasuar me vitin 2016. Më poshtë jepen shpjegimet detaje për pozitën aktuale.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	353,242	284,794	212,288	268,062	348,712
Pagat dhe Mëditjet	216,344	166,344	117,811	162,358	208,358
Mallrat dhe Shërbimet	130,448	117,000	94,056	103,343	139,134
Shërbimet komunale	6,450	1,450	421	2,361	1,220

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

- Buxheti për paga dhe mëditje është shpenzuar 71%. Niveli i ulët i shpenzimeve në këtë kategori ka ndodhë si rezultat i mos emërimit të pesë anëtarëve të Këshillit nga Kuvendi i Kosovës, e ku vlera vjetore e planifikuar e pagave të tyre ishte 78,600€. Po ashtu, në këtë nivel të ulët të realizimit ka ndikuar edhe mungesa e tre zyrtareve (një në pushim pa pagesë dhe dy zyrtare në pushime të lehonisë);
- Buxheti për mallra dhe shërbime është shpenzuar 80%. Në këtë nivel të shpenzimeve ka ndikuar fakti që sipas Ligjit të Prokurimit Publik procedurat e prokurimit për Agjencinë i udhëheqë Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP). Vonesa e lidhjes së kontratave të centralizuara nga AQP ka ndikuar që Agjencia të mos mund të furnizohet me disa produkte apo shërbime të cilat i kishte planifikuar që t'i realizojë gjatë këtij viti; dhe
- Buxheti për komunalitet është shpenzuar vetëm 29%. Shpenzimi ka ndodhë vetëm për telefoni fikse pasi që të gjitha shpenzimet komunale të objektit të agjencisë i kishte mbuluar Ministria e Administratës Publike (MAP).

Nga kjo analizë buxhetore vërehet se performanca e ulët buxhetore ishte kryesisht e ndikuar nga partnerët e jashtëm si Kuvendi dhe AQP-ja dhe ne në këtë raport nuk kemi ndonjë çështje për të ngritur në këtë aspekt.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.2 Pagat dhe shtesat

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave që menaxhohet nga MAP dhe MF. Kontrollat që operojnë në nivel të Agjencisë kanë të bëjnë me kontrollin e pagesave çdo muaj duke i nënshkruar listat e pagave, verifikimin e ndryshimeve të mundshme, rishikimin e buxhetit për këtë kategori dhe barazimet me Thesarin.

Agjencia kishte menaxhuar pagat në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.3 Menaxhimi i personelit

Numri i aprovuar i të punësuarve në Agjenci ishte 23, ndërsa numri aktual i të punësuarve në fund të vitit ishte 16 punonjës. Edhe pse ishin të planifikuar me buxhet dallimi prej shtatë të punësuarve është si rezultat i mos përzgjedhjes së Këshillit, një pushimi pa pagesë dhe një transferi.

Çështja 1 - Pozitat kyçe të paaprovuara me buxhet

E gjetura Neni 12,13 dhe 14 i Ligjit të Menaxhimit të Financave Publike thekson se çdo organizatë buxhetore duhet ta ketë pozitën e Zyrtarit Kryesor Financiar, Zyrtarit Çertifikues dhe Zyrtarit të Prokurimit. Në Agjenci, këto pozita nuk janë të aprovuara dhe që nga themelimi i agjencisë këto funksione ushtrohen nga personeli tjetër.

Për më tepër për këto funksione (pozita) agjencia ka aplikuar ushtrimin e tyre me rotacion ku deri më tani funksionin e ZKF-së e kanë ushtruar disa zyrtarë. Menaxhmenti ka bërë përpjekje për të siguruar aprovimin e këtyre pozitave dhe me buxhetin e vitit 2018 ka arritur të siguroj një pozitë për ZKF-në, e cila deri sa ne ishim në auditim ende nuk ishte plotësuar.

Rreziku Menaxhimi i funksioneve kyçe nga personeli jo adekuat dhe praktika e ndarjes së pozitave për kryerjen e detyrave me rotacion rrit rrezikun që zyrtarët e emëruar mund të hasin në pengesa në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësive në raport me kërkesat. Kjo ndikon që përgjegjësia dhe llogaridhënia në punë të mospërfillet dhe krejt kjo reflektohet edhe në menaxhimin jo efektiv.

Rekomandimi 1 Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj që pozitat kyçe të lartcekura të jenë të aprovuara me buxhet dhe sipas kërkesave të LMFP-së dhe të parandalojë ushtrimin e këtyre funksioneve me rotacion dhe nga personeli jo adekuat, me qëllim të përmirësimit të aktiviteteve në këto funksione.

Çështja 2 - Pushimi pa pagesë pa dëshmi që e arsyetojnë qëllimin e dhënies

E gjetura Në një rast Drejtori i Përgjithshëm, kishte aprovuar pushimin pa pagesë për një zyrtar për një periudhë një vjeçare, me arsyetimin e shkollimit jashtë vendit. Rregullorja 06/2011 e lejon dhënien e pushimit pa pagesë për ngritje profesionale, por kërkon nga udhëheqësi administrativ më i lartë që e aprovon vendimin që ta shqyrtoj kërkesën në bazë të dëshmive relevante dhe pastaj të marr vendimin.

Gjatë trajtimit të kësaj lënde ne nuk kemi vërejtur dëshmi relevante se kandidati ishte i pranuar apo regjistruar në ndonjë universitet siç e ka theksuar në kërkesë. Përkundër kësaj pushimi i ishte lejuar nga drejtori.

Rreziku Aprovimi i pushimit në mungesë të dëshmive, rritë rrezikun që zyrtari do ta përdorë pushimin pa pagesë për qëllime tjera në raport me qëllimin për të cilin i është aprovuar pushimi. Po ashtu, kjo ndikon që Agjencia për një vit të angazhojë zyrtarë tjerë me qëllim të përmbushjes së detyrave të mbetura, kurse në anën tjetër të mos e arrijë qëllimin për çka e ka aprovuar pushimin pa pagesë.

Rekomandimi 2 Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurohet që para se të aprovoj pushimet pa pagesë t'i ketë shqyrtuar dëshmitë relevante në mënyrë që vendimi të jetë në përputhje me rregulloren për dhënien e pushimit pa pagesë.

3.4 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2017 ishte 118,450€. Prej tyre ishin shpenzuar 94,477€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me shpenzime të trajnimit, mëditjeve jashtë vendit dhe drekave zyrtare, si dhe pagesa e tre zyrtarëve administrativ me kontratë për shërbime të veçanta. Agjencia përpos shpenzimeve të telefonisë nuk ka shpenzime tjera komunale, pasi që shpenzimet komunale administrohen nga MAP-i.

Çështja 3 – Anashkalim i rregullave të thesarit gjatë procesimit të pagesave

E gjetura Sipas rregullave të Thesarit, fillimisht duhet të bëhet kërkesa për blerje, zotimi i mjeteve, procedohet urdhër-blerja, pastaj të pranohet malli apo shërbimi, dhe pas pranimit të faturës të ekzekutohet pagesa.

Në nëntë pagesa në shumë prej 8,719€, kemi vërejtur se urdhërbljerjet ishin krijuar pas pranimit të faturës. Kjo çështje është duke u përsëritur qe dy vite radhazi, megjithëse në vitin 2017 ishte me një trend më të ulët.

- Rreziku** Pranimi i faturës dhe mallrave para procesimit të urdhër blerjes rrit rrezikun që të pranohen mallra dhe shërbime jashtë kërkesave të parapara, si në sasi ashtu edhe në cilësi.
- Rekomandimi 3** Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj se kontrollet në procesin e ekzekutimit të pagesave janë duke u monitoruar në vazhdimësi. Po ashtu, që malli/fatura nuk duhet pranuar para se të jetë procesuar urdhër blerja.

3.5 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Sipas PFV-ve, vlera neto e pasurisë kapitale të Agjencisë është 61,783€, ndërsa vlera e pasurisë jokapitale 14,748€ dhe e stoqeve 2,480€. Në vitin 2017 nuk kishte shtim (blerje) të pasurisë kapitale. Ne kemi rishikuar nëse procesi i regjistrimit dhe mënyra e mbajtjes së evidencës është në pajtueshmëri me kërkesat e Rregullores MF-nr.02/2013, për menaxhimin e pasurisë jo financiare të organizatave buxhetore.

Çështja 4 – Mos funksionalizimi i sistemit e-pasuria

- E gjetura** Rregullorja nr. 02/2013 thekson se pasuritë kapitale duhet të regjistrohen në regjistrin kontabël - SIMFK ndërsa pasuritë jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin “e - Pasuria”.
- Agjencia, ende nuk e ka në funksion programin qeveritar e-pasuria. Në mungesë të këtij programi, regjistri i pasurisë me vlerë nën 1,000€ është duke u mbajtur në një formë të Exel-it, ku ekziston mundësia e ndryshimeve në çdo kohë dhe pa lënë gjurmë.
- Rreziku** Mos funksionalizimi i sistemit e-pasuria, është në kundërshtim me rregulloren 02/2013 dhe paraqet rrezik në menaxhimin e pasurive jo kapitale dhe stoqeve për kontroll, si dhe paraqitje të plotë të vlerës.
- Rekomandimi 4** Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj funksionalizimin e sistemit e-pasuria dhe trajnimin e zyrtarit të pasurive nga ana e MAP-it.

3.6 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2017 ishte 1,320€, të cilat janë bartur për t’u paguar në vitin 2018.

Raportimi i obligimeve ishte bërë në përputhje me Rregullën Financiare nr. 02/2013 për raportimin e obligimeve të papaguara.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2016 ka rezultuar me tetë rekomandime. Agjencia kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do të zbatohen të gjitha rekomandimet, mirëpo nuk është zbatuar në tërësi. Nga tetë rekomandimet e dhëna, katër janë zbatuar plotësisht, tri janë në proces dhe një nuk është zbatuar.

Po ashtu, nga viti 2015 ishin bartur gjashtë rekomandime prej të cilave, tri janë të zbatuar, dy janë në proces dhe një nuk është zbatuar. Rekomandimi i pazbatueshëm ka rrjedhë pasi që prokurimet sipas LPP i kryen AQP-ja, dhe ka pas mangësi në funksionalizimin e plotë të procedurave të reja ndërlidhëse me AQP-në.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni Shtojcën II.

Çështja 5 – Zbatimi i rekomandimeve nga dy vitet paraprake

E gjetura Menaxhmenti ka bërë progres të kufizuar në zbatimin e rekomandimeve nga vitet paraprake pasi që vetëm gjysma e rekomandimeve të vitit të kaluar janë zbatuar plotësisht, kurse tjerat janë në proces të zbatimit ose nuk janë zbatuar. Agjencia nuk ka arritur të zbatoj plotësisht as rekomandimet e dhëna në vitin 2015 dhe nuk ka ndjekur ndonjë proces formal për të menaxhuar dhe monitoruar afatet e zbatimit të tyre.

Rreziku Zbatimi jo i plotë i rekomandimeve ndikon në përsëritjen e dobësive të identifikuar. Dobësitë e vazhdueshme të kontrolleve të menaxhmentit dhe kontrolleve të tjera në sistemet kyçe financiare të cilat nuk janë adresuar, kanë rezultuar në:

- Ushtrimin e funksioneve kyçe në financa nga personeli jo adekuat si rezultat i pozitive të paaprovuara;
- Mangësi në procesimin e urdhër blerjeve; dhe
- Mangësi në menaxhimin e pasurive jo kapitale

Rekomandimi 5 Drejtori i Përgjithshëm duhet të rishikoj dhe analizoj shkaqet e rekomandimeve të pazbatuara, dhe të përcaktojë një afat të ri kohor për zbatimin e rekomandimeve, përfshirë edhe stafin llogaridhënës. Implementimi duhet të monitorohet në vazhdimësi.

5 Qeverisja e mirë

Hyrje

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA-së me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i listave kontrolluese të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen MF-së.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentët tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Agjencia në përgjithësi ka kontrolle të mira në raport me obligimet ligjore të saj. Qeverisja në fushën e raportimit menaxherial dhe llogaridhënies, si dhe menaxhimin e rrezikut pasqyron një situatë pozitive. Agjencia ka marrë në konsideratë kërkesat ligjore të parapara me rregullat e MFK-së dhe ka përfunduar me kohë vetëvlerësimin por ka nevojë të përfshijë një vlerësim më kritik ndaj arritjes së rezultateve.

Sa i përket menaxhimit të rreziqeve është caktuar zyrtari përgjegjës për monitorimin e rreziqeve që kishte bërë rishikim mujor të rreziqeve. Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit. Agjencia kishte arritur t'i zbatoj rekomandimet e dhëna në fushën e qeverisjes në raportet e viteve paraprake. Për vitin 2017 në Agjenci, nuk ishte realizuar ndonjë auditim i brendshëm.

5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Agjencia nuk i plotëson kriteret, bazuar në U/A nr.23/2009 për themelimin dhe funksionimin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm. Drejtori i Përgjithshëm me qëllim të forcimit të kontrollit të brendshëm, kishte kërkuar nga Kuvendi si dhe Njësia e Auditimit të Brendshëm në kuadër të MF-së për të kryer shërbimet e auditimit të brendshëm. Përkundër kësaj për vitin 2017 nuk ishte realizuar asnjë auditim i brendshëm.

Rekomandime

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranimit i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Agjencia ka përgatitur regjistrin e rreziqeve krahas planit strategjik, duke identifikuar rreziqet domethënëse që mund të kenë ndikim tek organizata në lidhje me arritjen e objektivave të saj. Po ashtu, është caktuar edhe zyrtari që do të bëjë monitorimin e rreziqeve në periudha mujore. Procesi i raportimit të brendshëm në Agjenci funksionon sipas zingjirit llogaridhënës dhe strukturës organizative. Lidhur me këtë, menaxhmenti mban takime të rregullta, duke raportuar dhe diskutuar për të gjitha aktivitetet.

Një mangësi e cila reflekton në procesin e llogaridhënies por e cila varet nga Kuvendi i Kosovës është mungesa e Këshillit si pasojë e skadimit të mandatit. Tani ajo menaxhohet nga Drejtori i Përgjithshëm dhe është në proces ndryshimi dhe aprovimi i ligjit të ri për Agjencinë i cili planifikohet të aprovohet këtë vit.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e bartura nga viti 2015	Të zbatuara gjatë vitit 2017	Në proces të zbatimit gjatë 2017	Të pa zbatuara
2.3 Rekomandimet e vitit paraprak	Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror duhet të sigurojë një plan të rishikuar të veprimit, i cili përcakton qartë një afat kohor dhe stafin përgjegjës për adresimin e të gjitha rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm. Implementimi i këtij plani duhet të rishikohet në baza të rregullta kohore.		Agjencia kishte hartuar një plan për zbatimin e rekomandimeve, mirëpo një pjesë e rekomandimeve kanë mbetur të pa zbatuara.	
2.5.1 Vlerësimi i rrezikut	Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror duhet të sigurojë së kanë hartuar një plan për identifikimin, vlerësimin dhe evitimin e rreziqeve të cilat mund të paraqiten gjatë realizimit të objektivave strategjike dhe vjetore, si dhe ka caktuar një person përgjegjës për menaxhimin e rrezikut i cili raporton në baza mujore për zbatimin e kërkesave në këtë fushë.	Po		
3.4 Prokurimi	Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror duhet të sigurojë se kontrollet në procesin e ekzekutimit të pagesave janë duke u monitoruar në vazhdimësi. Prosesi i pagesave duhet të bëhet në pajtim të plotë me hapat e përcaktuar me LMFPP-në, dhe me rregullat e Thesarit.			Nuk janë marrë masa për zbatim.
	Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror duhet të sigurojë mbikëqyrje të rregullt të procesit të ekzekutimit të buxhetit, me qëllim që çdo faturë të paguhet brenda afatit të përcaktuar ligjor.	Po		

3.5.1 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)	Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror duhet të sigurojë kontrolle shtesë në menaxhimin e procedurave të rekrutimit. Procedurat e rekrutimit duhet të fillojnë me kohë, dhe kohëzgjatja e funksionit si ushtrues detyre të mos jetë më e gjatë se periudha e përcaktuar më kërkesat ligjore.		Për vitin 2018 është aprovuar pozita e ZKF-së, mirëpo ende nuk ishte plotësuar .Po ashtu nuk janë mbuluar pozita e Zyrtarit të certifikimit dhe Zyrtarit të prokurimit.	
3.6.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale Vonesa në regjistrimin e pasurive në regjistrin kontabël	Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror duhet të sigurojë se kontrollet në menaxhimin e pasurisë janë duke u monitoruar në vazhdimësi. Regjistrat e pasurisë duhet të azhurnohen rregullisht nga zyrtarët përgjegjës si dhe në fund të çdo viti ky regjistër duhet të harmonizohet më regjistrin e inventarizimit të pasurisë. Më tej të sigurojë se janë duke vazhduar përpjekjet (kërkesat në MAP) për instalimin e sistemit e-pasuria		Pajisjet ishin pajisur me barkode, mirëpo ende nuk është futur në përdorim sistemi e-pasuria.	
3.6.2 Trajtimi i borxheve	Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror duhet të siguroj se janë marrë veprimet e nevojshme për të përmirësuar mënyrën e raportimit të obligimeve, qoftë përmes trajnimit të stafit, ose përmes formave tjera.	Po		
Komponenta e auditimit	Rekomandimet e dhëna në vitin 2016	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak	Drejtori i Përgjithshëm duhet të zbatojë një proces efektiv për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve, i cili përcakton kohën e synuar dhe zyrtarët përgjegjës në këtë proces. Procesi të rishikohet në vazhdimësi në mënyrë që të ndërmerren veprime ndaj barrierave të paraqitura gjatë zbatimit.		Agjencia kishte hartuar një plan për zbatimin e rekomandimeve, mirëpo një pjesë e rekomandimeve kanë mbetur të pa zbatuara.	

2.2 Pyetësi i vet-vlerësimit të komponentëve të MFK-së	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë që ka deleguar përgjegjësinë e drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut dhe të sigurojë raportim për zbatimin e kërkesave në këtë fushë duke monitoruar menaxhimin e rreziqeve në vazhdimësi.	Po		
3.1.1 Pagat dhe mëditjet	Drejtori i Përgjithshëm duhet të ndërmerr veprime për rekrutimin e stafit të rregullt sipas kërkesave ligjore në mënyrë që të ndërpritet mbulimi i pozitave me UD. Pozitat me UD nuk duhet të jenë më e gjatë se periudha e përcaktuar ligjore.		Për vitin 2018 është aprovuar pozita e ZKF-së, mirëpo ende nuk ishte plotësuar .Po ashtu nuk janë mbuluar pozita e Zyrtarit të certifikimit dhe Zyrtarit të prokurimit.	
3.1.2 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë që kontrollet në procesin e ekzekutimit të pagesave janë duke u monitoruar në vazhdimësi. Procesi i pagesave duhet të bëhet në pajtim të plotë me hapat e përcaktuar me LMFPF, dhe me rregullat e Thesarit.			Nuk janë marrë masa për zbatim.
3.1.2 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë kontroll të duhur, në mënyrë që pagesat të kryhen sipas kushteve të kontratës dhe brenda afateve ligjore të saj.	Po		
3.1.2 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë mbikëqyrje të rregullt të procesit të ekzekutimit të buxhetit me qëllim që çdo faturë të paguhet brenda afatit të përcaktuar ligjor.	Po		

3.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Drejtori i Përgjithshëm, duhet të forcoj kontrollet për të siguruar se të gjitha pasuritë janë pajisur me të gjitha elementet e kërkuara për të siguruar menaxhim më efikas të tyre.		Pajisjet ishin pajisur me barkode, mirëpo ende nuk është futur në përdorim sistemi e-pasuria.	
3.3 Obligimet e papaguara	Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj kontrolle shtesë në raportimin e obligimeve, ashtu që vlerat e sakta të raportohen për periudha të sakta kohore dhe të përcillen nga muaji në muaj derisa të paguhen.	Po		

Shtojca III: Letërkonfirmimi



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Državna Agencija za Zastitu Ličnih Podataka
National Agency for Protection of Personal Data

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2017 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017 (në tekstin e mëtejme "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre dhe shterrjen e mundësive menaxheriale me kërkesa për institucionet përgjegjëse për shtimin e personelit adekuat në financa.

Bujar Sadiku, Drejtor i Përgjithshëm

Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

Data: 13.Prill.2018, Prishtinë

